

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7013
E enjte, 5 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Hovenieri thotë se
ShBA-ja është e gatshme
ta këshillojë Kosovën për
asociacionin | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI PA KUORUM PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE, KONJUFCA: NUK IA VLEN TË EKZISTOJË KJO LEGJISLATURË | **FAQE 4**



Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur t'i votojë të mërkurën katër marrëveshje ndërkombëtare pasi nuk ka pasur kuorumin e dy të tretave të votave të deputetëve.

Opozita tha se nuk ka votë për këto marrëveshje, duke kërkuar caktimin e datës së zgjedhjeve të reja parlamentare.
Kryeparlamentari Glauk

Konjufca ka theksuar se një Kuvend që nuk e ka kapacitetin t'i kalojë marrëveshjet ndërkombëtare nuk ia vlen të ekzistojë

MILLAN RADOIÇIQI LIROHET NGA MBAJTJA, I NDALOHEK VAJTJA NË KOSOVË | **FAQE 3**



ISH-KËSHILLTARI I THAÇIT: SPECIALJA DUHET TA MBYLLË ZYRËN NË BEOGRAD DHE T'I SHPALLË TË PAVLEFSHME DËSHMITË E SERBISË | **FAQE 7**



AKTUALE



SHKARKOHET KRYETARI I DHOMËS SË PËRFAQËSUESVE NË SHBA | **F. 2**

OSMANI NË CNN: KOSOVA ËSHTË VIKTIMË E NJË AKTI TË AGRESIONIT NGA SERBIA | **F. 3**

NË PARLAMENTIN EVROPIAN KËRROHET SANKSIONIMI I SERBISË PËR DHUNËN NË KOSOVË | **F. 5**

ISH-MINISTRI I JASHTËM: SIGURIA PARA NORMALIZIMIT | **F. 6**

EKONOMI



GUVERNATORI I BQK-së THOTË SE MUNGESA E KARTONIT TË GJELBËR PO SHKAKTON PENGESA PËR BIZNESET E QYTETARËT | **F. 8**

PËR GJASHTË MUAJ KUVENDI SHPENZOI AFËR 4 MILIONË EURO | **F. 8**

SPORT



BALLKANI SYNON REZULTAT POZITIV NDAJ DINAMO ZAGREBIT | **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama për "The Financial Times": NATO-ja ta rivendosë kontrollin në veri



TIRANË, 4 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka paralajmëruar aleancën euroatlantike, se nëse nuk rivendos kontrollin në veriu e Kosovës, do të përballlet me dhunën e vazhdueshme midis serbëve dhe shqiptarëve etnikë në rajon.

Në një intervistë për prestigjiozen britanike "The Financial Times" pas tensioneve në veri, ku forcat paramilitare serbe vranë një efektív shqiptar dhe më pas morën peng Manastirin e Banjskës, ndërsa nga shkëmbimi i zjarrit me autoritetet ligjzbatuese mbetën

të vdekur tre terroristë, Rama e konsideroi Kosovën një pikë të nxehtë. "Kosova është një pikë e nxehtë. Me kalimin e viteve është bërë toka e askujt, ku të gjitha llojet e krimeve kombinohen me nacionalizmin në rritje. Kufiri mes krimit dhe politikës është zbehur", tha Rama.

NATO tha se do të vendoste sa më shumë trupa paqeruajtëse të nevojshme për ta stabilizuar situatën, ndërsa Gjermania dhe Britania e Madhe tashmë kanë premtuar dislokimin e qindra ushtarëve në krye të forcës ekzistuese prej 4 500 trupash për

ta mbajtur rajonin nën kontroll. Udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë i kanë bërë thirrje NATO-s që ta rrisë praninë e saj ushtarake dhe t'i qetësojë tensionet. Kosova e ka fajësuar Serbinë për sponsorizimin e sulmit dhe për lëvizjen e njësisë të ushtrisë afër kufirit të Kosovës, në atë që tregonte qëllime luftarake.

Rama përkrahu një konferencë të nivelit të lartë që përfshinte liderët e Francës dhe Gjermanisë dhe riangazhimin e ShBA-së. "Kjo është mënyra më e mirë për të dalë nga kjo çmenduri e pafund", tha ai.

Shkarkohet kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve në ShBA

WASHINGTON, 4 TETOR - Kevin McCarthy është shkarkuar nga pozita e kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara në një votë mosbesimi. Kjo është hera e parë në historinë amerikane që shkarkohet një zyrtar prej kësaj pozite përmes një votimi kësisoj.

McCarthy është shkarkuar nga pozita e liderit të shumicës së republikanëve në këtë dhomë të Kongresit me 216 vota për dhe 210 kundër.

Politikanët e linjës së ashpër kanë votuar për largimin e tij, pasi McCarthy e ka arritur një marrëveshje me demokratët e

Senatit për t'i financuar agjencitë qeveritare.

Aktualisht nuk ekziston një emër që do ta mbikëqyrë shumicën e republikanëve në këtë dhomë.

Kongresi i ka rreth 40 ditë për ta arritur një marrëveshje që shmang mbylljen e qeverisë amerikane.

Republikani nga Florida Matt Gaetz, aleat i ish-presidentit amerikan Donald Trump, e ka nisur procedurën për shkarkimin e McCarthyt.

Ai e ka akuzuar kreun e deritanishëm për arritjen e një marrëveshjeje sekrete me Shtëpinë e Bardhë për ta vazhduar

financimin për Ukrainën teksa është negociuar shmangia e mbylljes qeveritare në fundjavë. McCarthy e ka hedhur poshtë diçka të tillë.

Ish-presidenti Trump ka thënë se partia duhet t'i luftojë "demokratët e majtë radikalë" dhe jo njëri-tjetrin.

Sekretarja për medie e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre, ka thënë përmes një deklarate se presidenti amerikan Joe Biden është duke shpresuar që Dhoma e Përfaqësuesve të gjejë shpejt një emër të ri për kryetar, duke përmendur se "sfidat me të cilat përballlet kombi ynë nuk mund të presin".



Fqinjët e Sllovakisë i rritin kontrollet kufitare shkaku i emigrantëve

BRATISLAVË, 4 TETOR - Republika e Çekisë dhe Polonia kanë ndërmarrë veprime të bashkërenduara më 3 tetor për rritjen e kontrolleve përgjatë kufijve të tyre me Sllovakinë, për ta frenuar emigrimin e jashtëligjshëm dhe kontrabandën.

Austria i ndoqi hapat e tyre pak më vonë.

Kontrollet, të cilat e kanë zemëruar Sllovakinë, filluan sot dhe do të zgjasin 10 ditë.

Republika e Çekisë, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia kanë qenë aleatë në kundërshtimin e planeve të Bashkimit Evropian për emigrimin, siç janë kuotat, në të kaluarën. Por, duke qenë se të gjitha këto vende janë në Zonën Shengen të BE-së për lëvizjen e lirë pa viza, kontrollet e shtuara gjatë kohëve të fluksit të ngritur të emigrantëve, kanë shkaktuar ndarje politike dhe tregtare.



Emigrimi i jashtëligjshëm ishte temë kyçe në zgjedhjet e fundjavës së kaluar në Sllovaki

dhe do të jetë në zgjedhjet e Polonisë në fund të këtij muaji. "Këto masa janë të nevojshme për

luftë efektive kundër grupeve të trafikuesve dhe emigrimit të jashtëligjshëm", tha ministri i

Brendshëm i Çekisë, Vit Rakusan, dje në X, ish-rrjetin social të njohur më parë si "Twitter".

Të martën më vonë, ministri i Brendshëm i Austrisë, Gerhard Karner, tha se Vjena do të bëjë kontrolle të njëjta në kufirin e saj me Sllovakinë.

Qeveria sllovaqe tha se do të reagojë ndaj vendimeve të Çekisë dhe Polonisë të mërkurën. Kryeministri në detyrë i Sllovakisë, Ludovit Odor, tha se kjo çështje duhet të rregullohet "në mënyrë evropiane".

Sllovakia është përballur me një numër në rritje të emigrantëve të jashtëligjshëm, të cilët kalojnë përmes saj në Gjermani dhe në Evropën perëndimore. Emigrantët, kryesisht djem të rinj nga Lindja e Mesme dhe Afganistani, kanë ardhur kryesisht përmes së ashtuquajturës rruga ballkanike, përmes Hungarisë nga Serbia.

Osmani në CNN: Kosova është viktimë e një akti të agresionit nga Serbia

PRISHTINË, 4 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se "Kosova është duke u sulmuar" dhe se është "viktimë e një akti të agresionit nga Serbia", pas sulmit nga grupe të armatosura serbësh ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit javë më parë.

Më 24 shtator grupe të armatosura serbe sulmuan policinë e Kosovës në fshatin e komunës së Zveçanit, Banjskë, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Në shkëmbimin e zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulmues. "Derisa ne po flasim, Kosova po përballet me sfida të papara; me sfida të sigurisë që vijnë nga akti i agresionit të Serbisë që ndodhi më 24 shtator.

Ishte një akt agresioni i urdhëruar nga vendimmarrësit, nga shteti i Serbisë, e i kryer nga grupet terroriste paramilitare", tha Osmani për CNN.

Serbia i ka mohuar akuzat e Kosovës se qëndron prapa këtij sulmi.

Por, Osmani nguli këmbë se "ky agresion nuk ndodhi vetëm një herë dhe ishte i planifikuar dhe përgatitur shumë mirë me qëllimin e vetëm për ta aneksuar veriun e Kosovës në stilin e Krimesë", duke iu referuar aneksimit të Gadishullit ukrainas nga Rusia në vitin 2014.

Pesë ditë më vonë përgjegjësini për sulmin e mori Millan Radoiçiqi, i cili u mor në pyetje

sot nga prokuroria serbe në Beograd, por Osmani nuk beson se Serbia do ta dënojë apo ekstradojë atë tek autoritetet e Kosovës. "Natyrisht, gjëja e parë që ne e duam është që [shteti serb] t'ia dorëzojë Radoiçiqin dhe terroristët e tjerë Republikës së Kosovës në mënyrë që drejtësia të vihet në vend. Serbia nuk ka histori të mirë për vënien e drejtësisë në vend", tha Osmani për televizionin amerikan CNN. Ajo theksoi se "nuk ka asnjë rast kur kriminelët që kanë kryer krime lufte dhe gjenocid në Kosovë dhe Bosnjë që janë vënë para drejtësisë".

Osmani e akuzoi Serbinë për "përpjekje të vazhdueshme për ta

destabilizuar" Ballkanin Perëndimor, për t'ia mundësuar presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, hapjen e "një fronti të ri" kundër Perëndimit në Ballkanin Perëndimor.

Ajo e përmendi zhvendosjen e ushtrisë serbe përgjatë kufirit me Kosovën javën e kaluar, gjë të cilën Serbia e ka mohuar, pavarësisht se u qortua nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Ne po punojmë me aleatët dhe partnerët tanë për të mos lejuar të ndodhë kjo", tha ajo.

Megjithatë, Osmani beson se Serbia mund ta përsërisë "dhunën jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe ndaj pjesës tjetër të

rajonit", nëse nuk përballet me masa të ashpra. Osmani i hodhi poshtë pretendimet e autoriteteve serbe se armët e përdorura nga grupi i udhëhequr nga Radoiçiqi ishin siguruar në Tuzell të Federatës së Bosnjë-Hercegovinës.

Policia e Kosovës gjeti dhe konfiskoi arsenal të jashtëzakonshëm armësh pas sulmit në veri. "Armët që ne i kemi konfiskuar tregojnë se ato ishin prodhuar vetëm gjashtë javë më parë në bazat ushtarake në Serbi", shtoi Osmani.

Ajo nënvizoi se armët e tilla nuk përdoren nga qytetarët e zakonshëm, "por vetëm nga shteti dhe nga ushtria".



Millan Radoiçiqi lirohet nga mbajtja, i ndalohet vajtja në Kosovë

PRISHTINË, 4 TETOR - Gjykata e Lartë në Beograd ka njoftuar se e ka liruar nga mbajtja ish-nënkryetarin e Listës Serbe, Millan Radoiçiq, një ditë pas marrjes në pyetje.

Gjyqtari i procedurës paraprake e ka refuzuar propozimin e Prokurorisë së Lartë Publike në Beograd për caktimin e masës së paraburgimit për Radoiçiqin pas intervistimit.

Prokuroria e ka kërkuar paraburgimin me arsyetimin e rrezikut të arratisjes.

Më 29 shtator Millan Radoiçiqi e ka marrë përgjegjësinë për organizimin dhe sulmin në Banjskë të Zveçanit në veri të

Kosovës.

Si pasojë e sulmeve është vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, ndërsa në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë.

Me vendimin e 4 tetorit, Radoiçiqi i është ndaluar largimi prej territorit të Serbisë pa miratim të gjykatës dhe i është ndaluar të shkojë në territorin e Kosovës.

Sipas këtij vendimi, ai do të duhet të paraqitet në stacionin policor kompetent me datat 1 dhe 15 të çdo muaji.

Është thënë se atij i është konfiskuar përkohësisht dokumenti i udhëtimit,



përkatesisht pasaporta e Republikës së Serbisë, dhe ai është paralajmëruar se mund t'i

shqiptohet paraburgimi nëse i shkel të drejtat dhe detyrimet. Radoiçiqi akuzohet në Serbi për

blerje të armëve, municioneve dhe mjeteve shpërthyes me fuqi të madhe shkatërruese nga Tuzlla në Bosnjë-Hercegovinë, nga janari 2023 deri më 24 shtator.

Ai është ndaluar për 48 orë nga autoritetet në Serbi më 3 tetor. Radoiçiqi e ka mohuar kryerjen e këtyre krimeve.

Kosova e ka bërë fajtores Serbinë për sulmin në Banjskë, të cilin e ka konsideruar "akt terrorist".

Beogradi, në anën tjetër, i ka hedhur poshtë këto akuza, duke thënë se serbët lokalë në Kosovë "janë rebeluar kundër terrorit të Kurtit", duke iu referuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit.

Në Parlamentin Evropian kërkohet sanksionimi i Serbisë për dhunën në Kosovë



PRISHTINË, 4 TETOR - Disa eurodeputetë kanë kërkuar sanksionimin e Serbisë gjatë një seance për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE) të martën, ku u diskutua për sulmin vdekjeprurës ndaj Policisë së Kosovës nga një grup i armatosur serbësh javë më parë në veri të vendit. Deputeti kroat Tonino Picula, duke folur në emër të grupit socialist, kërkoi masa ndaj Serbisë, duke e cilësuar terrorist sulmin e 24 shtatorit ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. “Ngjarjet e fundit janë evidencë se sa e rrezikshme është situata. Jemi të shqetësuar për sjelljen e Serbisë edhe pas këtyre ngjarjeve”, tha Picula. Përgjegjësini për sulmin e mori Millan Radoičiqi, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e

Beogradit zyrtar, por Kosova ngul këmbë se shteti serb qëndron pas sulmit. Ai theksoi se Bashkimi Evropian duhet të vendosë masa të ngjashme ndaj Serbisë siç bëri kundër Kosovës muaj më parë. BE-ja kishte vlerësuar se Kosova nuk i kishte ndërmarrë hapat e kërkuar për uljen e tensioneve në veri. Deputetja gjermane Viola von Cramon, e cila është edhe raportuese për Kosovën në PE, tha se sulmi “brutal dëshmon se nuk mund ta marrim lirinë si të garantuar në Evropë”. Ajo nënvizoi se lidhjet e Radoičiqit me Beogradin zyrtar “janë më se evidente” dhe se Serbia “menjëherë” duhet t’i tërheqë të gjitha trupat nga kufiri me Kosovën. “BE-ja dhe NATO-ja duhet të dalin me plan të ri për Kosovën. Gjermania duhet ta ndjekë shembullin e Britanisë për ta rritur praninë ushtarake në Kosovë”, tha ajo, duke iu

referuar vendimit të javës së kaluar të Britanisë së Madhe për dërgimin e 200 trupave shtesë në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Eurodeputeti holandeze Thijs Reuten kërkoi hapa “vendimtarë për ta ndalur presidentin e Serbisë, Vuçiq”. “Vuçiqin duhet ta ndalim sepse ai nuk ndalet vetë. Nëse një herë e tolerojmë e nuk e ndalim, herën tjetër shkon një shkallë më larg. Krejt çka BE-ja ka bërë është sanksionimi i Kosovës”, theksoi ai duke kërkuar masa ndaj Serbisë. Në debat pati shumë kritika edhe për politikën e BE-së ndaj Serbisë dhe për neglizhencën ndaj ndikimit të Rusisë në rajon. Disa deputetë bënë thirrje për hetime ndërkombëtare dhe që përgjegjësit e sulmit ndaj Policisë së Kosovës në veri të vihen para drejtësisë. Disa eurodeputetë madje

kërkuan që Serbisë t’i ngrihen fondet derisa të kryhen hetimet. Ata e kritikuan BE-në për “përdorimin e një politike të butë” ndaj Serbisë, për trajtimin e Vuçiqit si “mik, duke i dhënë fonde dhe duke hezituar ta dënojnë pushtetin e tij”. Komisionari për çështje humanitare, Janez Lenarçiq, foli në emër të Komisionit Evropian në mungesë të përfaqësuesit të Lartë të BE-së, Josep Borrell, i cili ishte në udhëtim zyrtar. Ai e kritikoi Serbinë për veprimet pas sulmit të 24 shtatorit, e cila i lartësoi tre sulmuesit serbë që u vranë pasi e sulmuan Policinë e Kosovës dhe shpalli zi për ta. “Retorika nga Beogradi pas ngjarjeve të 24 shtatorit është shumë shqetësuese. Sikur edhe mbajtja e zisë për sulmuesit e vrarë. Edhe rritja e pranisë ushtarake në jug të Serbisë

është shqetësuese”, tha ai. Eurodeputeti sllovak Vladimir Biličik, i cili është edhe raportues për Serbinë, e fajësoi kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për gjendjen në veri. “Procesi i dialogut nisi të ngeçë me ardhjen e Albin Kurtit në pushtet. Refuzimi i tij për themelimin e Asociacionit krijoi situatën në të cilin ka ngecur dialogu. Nuk mund të ketë zgjidhje pa kompromis”, tha ai. Eurodeputetët që e kritikuan Kosovën e bënë këtë kryesisht duke thënë se ajo “po tregon mosgatishmëri” për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Deputetët e ekstremit të djathtë e fajësuan Kosovën për “nxitjen e serbëve për t’u detyruar të mbrohen”. Parlamenti Evropian në seancën e ardhshme gjatë muajit tetor do ta miratojë edhe një rezolutë të veçantë për situatën në Kosovë.

Kuvendi pa kuorum për marrëveshjet ndërkombëtare, Konjufca: Nuk ia vlen të ekzistojë kjo legjislaturë

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur t'i votojë të mërkurën katër marrëveshje ndërkombëtare pasi nuk ka pasur kuorumin e dy të tretave të votave të deputetëve. Opozita tha se nuk ka votë për këto marrëveshje, duke kërkuar caktimin e datës së zgjedhjeve të reja parlamentare. Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka theksuar se një Kuvend që nuk e ka kapacitetin t'i kalojë marrëveshjet ndërkombëtare nuk ia vlen të ekzistojë



Por, jo me këtë jonfunksionalitet që është duke vazhduar që një kohë të gjatë, nuk ia vlen shpenzimi i parasë publike", ka thënë Tahiri.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, e ka demantuar deklaratën e ministrit të Financave, Hekuran Murati, i cili pati thënë se LDK-ja është kundër marrëveshjeve ndërkombëtare.

Gashi gjatë seancës plenare të mërkurës ka thënë se deklarata të tilla janë të pasakta. "Në vazhdimësi kemi parë shpifje dhe të pavërteta nga ministri i Financave, i cili deklaroi në 'Facebook' se grupi parlamentar i LDK-së nuk po i përkrah marrëveshjet ndërkombëtare, që është e pavërtetë. Ne i kemi përkrahur, përveç marrëveshjes me OPEC-un, të gjithë marrëveshjet e tjera", ka thënë Gashi.

Ai tha se "mendoj që është e padrejtë, e pasaktë dhe e paduhur dhe nuk i kontribuon ndërtimit të një konsensusi në Kuvend për kalimin e këtyre projektligjeve. Duhet me u ndal mos me rrejt me ministri i Financave për këto çështje", ka thënë Gashi.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i ka shtyrë për seancën e radhës marrëveshjet ndërkombëtare për shkak të mungesës së kuorumit, të cilat ishin në rend dite për votim në seancën e së mërkurës.

Katër marrëveshje që dështuan të miratohen ishin: Votimi i Projektligjit nr. 08/L-222 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim për Projektin "Ngrorhtorja solare e Prishtinës", votimi i Projektligjit nr. 08/L-223 për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave të

arsimit të lartë në nivelin master në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë, shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-234 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-236 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze. Kryeparlamentari Konjufca pas kësaj tha se një kuvend që nuk e ka kapacitetin t'i kalojë marrëveshjet ndërkombëtare nuk

ia vlen të ekzistojë. "Me thanë të drejtën, unë si kryetar i Kuvendit të Kosovës mendoj se një Kuvend i cili nuk e ka kapacitetin objektiv për të kaluar marrëveshje ndërkombëtare nuk ia vlen të ekzistojë si legjislaturë", ka thënë Konjufca.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se nuk do t'i votojë marrëveshjet ndërkombëtare deri kur të merret vendimi për shkuarje në zgjedhje të reja. "Grupi parlamentar i PDK-së e ka qëndrimin e qartë sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për të gjithë

projektligjet që vijnë këtu në Kuvend. Ne nuk votojmë. Krejt çka kërkojmë dhe angazhohemi është që kjo legjislaturë të marrë fund sa më shpejt dhe ta caktojë datën e zgjedhjeve", ka thënë ai.

Tahiri ka thënë se pasi të pajtohen për datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, atëherë brenda asaj dite do t'i kalojnë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare. "Pra, atë ditë që ne dakordohemi që të shpërndahet ky parlament, të njëjtën ditë do t'i kalojmë marrëveshjet ndërkombëtare.

Hovenieri thotë se ShBA-ja është e gatshme ta këshillojë Kosovën për asociacionin



PRISHTINË, 4 TETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se ShBA-ja është e gatshme ta këshillojë Kosovën për hartimin e statutit për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. "Në fund, kjo çështje do t'i përkasë dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja. Mirëpo, nëse Kosova dëshiron të konsultohet me ne, ose të tjerët, se si të çojë diçka përpara në mënyrë më të mirë, ne jemi të gatshëm ta këshillojmë", tha ai në një

bashkëbisedim me gazetarët në ambasadë.

Hovenieri ka theksuar se ShBA-ja do ta mirëpresë secilin propozim të Kosovës në këtë temë por, sipas tij, duhet të jetë "kredibil dhe i arsyeshëm".

Ky reagim i diplomatit amerikan vjen pak ditë pasi presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një intervistë për Radio Televizionin e Kosovës, ka thënë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta marrin rolin udhëheqës të procesit

të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi që aktualisht ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Ambasadori amerikan ka thënë se çështja e përgjegjësive mbi sulmin ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit nuk beson se merr fund me deklarin e ish-nënkryetarit të Listës Serbe Millan Radoičiq, se ai e ka organizuar sulmin. "Do të thosha që gjëja e duhur për shërbimet tona të sigurisë dhe partnerë të tjerë është që të vazhdojmë të tentojmë të

kuptojmë se çfarë ka ndodhur. Shtetet e Bashkuara kanë qenë të qarta. Ata që mbajnë përgjegjësi për sulmin duhet të mbahen përgjegjës. Ky mbetet pozicioni ynë. Ne do të vazhdojmë të tentojmë për të kuptuar çfarë ka ndodhur, kush është përgjegjës dhe pse", ka thënë Hovenier.

I pyetur nëse ShBA-ja ka informacione për planet e grupit të armatosur dhe nëse është përfshirë Beogradi zyrtar në sulme, në ndonjë mënyrë, Hovenieri ka thënë se

ShBA-ja është ende duke mësuar më shumë për rastin. "Kjo gjë merr kohë. Ka qenë një rrethanë e komplikuar dhe do të marrë kohë derisa t'i kuptojmë të gjitha specifikat".

Megjithatë, Hovenieri ka përsëritur se ShBA-ja beson se sulmi nuk ka qenë spontan dhe grupi ka qenë "i koordinuar", i cili ka përdorur armë të sofistikuara të gradës ushtarake - një pjesë e mirë e të cilave kanë qenë me origjinë serbe - me qëllim të destabilizimit të veriut të Kosovës.

Ish-ministri i Jashtëm: Siguria para normalizimit

PRISHTINË, 4 TETOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se formula e Kosovës

për ta mbrojtur sovranitetin pas aktit të agresionit më 24 shtator është vendosja e sigurisë para normalizimit si prioritet dhe vendosmëria për

anëtarësim në NATO para anëtarësimit në BE-së. “Kosovës i duhet politikë e re e sigurisë, buxhet më shumë, rritje të numrit të pjesëtarëve, paga më të

larta dhe pajisje moderne, në këtë kohë kur në Serbi opsioni ushtarak kundër Kosovës është opsion real”, ka shkruar Hoxhaj në “Facebook”.



Nis projekti madhor në Lipjan, mbi 6 milionë euro investim në qendrën e qytetit

LIPJAN, 4 TETOR - Të mërkurën kanë nisur punimet në projektin më të rëndësishëm infrastrukturor në qytetin e Lipjanit, ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan.

Kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, zotimin e tij para qytetarëve lipjanas për fillimin e realizimit të këtij projekti e vlerësoi më të rëndësishmin në Lipjan i cili do ta transformojë

qytetin në një qendër në funksion të mirëqenies së qytetarëve.

Ahmeti tha se ky është një ndër projektet më të mëdha të komunës së Lipjanit i cili kap vlerën e mbi 6 milionë euro, i cili përfshin katër projekte të integruara në një projekt dhe do të mundësojë zgjidhjen e problemit me trafikun e dendur. “Është një ndër projektet më madhore të qytetit të Lipjanit që besoj se do t’ia ndërroj pamjen tërësisht qytetit. Ne kemi

identifikuar nevojën e madhe të parkingut, nevojën e madhe të parkut, pastaj integrimin e sheshit dhe zgjidhjen e problemeve të trafikut. Janë katër projekte të integruara në një projekt”, ka thënë Ahmeti, duke bërë me dije se projekti do të zgjasë rreth tre vjet. “Është një projekt që do t’i zgjedhë njëkohësisht të gjitha problemet që kanë të bëjë me parkingun, do të ketë parkun qendror të qytetit, por edhe vazhdimin e sheshit”, ka thënë Ahmeti.



Haradinaj: Përherë do ta kujtojmë Deli Lekën si atdhetar e trim

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe në njëvjetorin e ndarjes nga jeta të bashkëluftëtarit të tij, Deli Leka. “Fshati Lumbardh iu përgjigj thirrjes së atdheut në luftën për çlirim duke mos e kursyer asnjëherë jetën e bijve të tyre. Një ndër ta ishte edhe bashkëluftëtarim, Deli Leka. Qysh në fillim të luftës çlirimtare ai u rreshtua krahas bashkëluftëtarëve të UÇK-së”, ka thënë Haradinaj.

Ai ka thënë se sot në njëvjetorin e ndarjes nga jeta të Deli Lekës ishte i nderuar të ishte pjesë e ceremonisë së akademisë dhe zbulimit të pllakës përkujtimore në nderim të veprës së tij, si dhe të qëndrojë në familjen Leka, e cila përgjatë historisë dha kontribut të çmuar në lëvizjen kombëtare shqiptare për çlirim dhe pavarësi. “Përherë do ta kujtojmë kontributin e tij atdhetar, trimërinë e guximin në rrugën drejt lirisë dhe shtetndërtimit”, ka theksuar Haradinaj.

Policia ndjek trajnimin për qasje në dokumente publike

PRISHTINË, 4 TETOR - Policia e Kosovës dhe menaxhmenti i saj ndër vite është përpjekur për ta avancuar qasjen në dokumente publike dhe informacione për qytetarë, media dhe OJQ, në pajtim me ligjet në fuqi. Të mërkurën në Prishtinë,

me përkrahjen e Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe UNDP-së, është mbajtur trajnimi me temën “Zbatimi në praktikë i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike”.

Ky trajnim, në të cilin marrin pjesë përfaqësues të

departamenteve policore nga niveli qendror, drejtorë rajonalë policorë, zëdhënës të policisë dhe përfaqësues nga zyra ligjore e PK-së, do të ndikojë në forcimin e kësaj përpjekje për një transparencë edhe më të madhe në këtë fushë.



Ish-këshilltari i Thaçit: Specialja duhet ta mbyllë zyrën në Beograd dhe t'i shpallë të pavlefshme dëshmitë e Serbisë

PRISHTINË, 4 TETOR - Artan Behrami, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka vlerësuar se sulmi terrorist në Banjskë duhet ta prekë edhe Gjykatën Speciale. Ai ka kërkuar që të mbyllet zyra e Speciales në Beograd. Behrami ka shkruar në "Facebook" se kjo gjykatë

duhet të marrë vendim që t'i shpallë të pavlefshme të gjitha dokumentet, informacionet dhe dëshmitarët e rekrutuar nga Serbia. "Gjykata Speciale duhet ta mbyllë zyrën e saj në Beograd. Ndërsa, trupi gjykoës i Dhomave të Specializuara duhet të marrë vendim që t'i shpallë të pavlefshme të gjitha

dokumentet, informacionet dhe dëshmitarët e rekrutuar nga Serbia. Krijimi i një bilanci artificial ndërmjet Serbisë fashiste, tashmë zyrtarisht sponsorizuese e terrorizmit, si dhe Kosovës si modele e respektimit të drejtave të njeriut, duhet të ndalet!", ka shkruar Behrami.



Hapet pikëkalimi kufitar në Bërnjak

PRISHTINË, 4 TETOR - Bërnjaku, një prej pikave kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë, është hapur të mërkurën për qarkullim, ka thënë zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës, Veton Elshani, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë".

Kjo pikë kufitare, bashkë me Jarinjën, janë mbyllur për qarkullim më 24 shtator, pas sulmeve të armatosura ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit.

Si pasojë e sulmeve është vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, ndërsa në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë.

Elshani ka thënë se pika kufitare në Jarinjë vazhdon të jetë e mbyllur për shkak të kërkimeve në terren në atë rajon. "Ende nuk ka ardhur urdhri për hapje për Jarinjë", ka thënë mes tjerash




Elshani.

Kosova e ka bërë fajtores Serbinë për sulmin në Banjskë, të cilin e ka konsideruar "akt terrorist".

Beogradi, në anën tjetër, i ka hedhur poshtë këto akuza, duke thënë se serbët lokalë në Kosovë "janë rebeluar kundër terrorit të Kurtit", duke iu referuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit.

Më 29 shtator Millan Radoičiq e ka marrë përgjegjësinë për organizimin dhe sulmin në Banjskë. Të njëjtën ditë ai ka dhënë dorëheqje nga pozita e nënkryetarit të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila e gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Radoičiqi është marrë në paraburgim për 48 orë nga autoritetet në Serbi më 3 tetor, por më 4 tetor është liruar nga paraburgimi.

Kosova përgatitet për pjesëmarrje në Expo 2025 në Osaka



PRISHTINË, 4 TETOR - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, ka pritur të mërkurën në një takim ambasadorin jorezident të Japonisë në Kosovë, Ryuta Mizuuchi.

Situata e sigurisë në vend, zgjerimi i bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Japonisë, si dhe bashkëpunimi në fushën akademike, ishin temat kryesore të këtij takimi.

Sa i përket pikës së parë, zëvendësministrja Gashi fillimisht

njoftoi ambasadorin Mizuuchi për sulmin terrorist të 24 shtatorit ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës dhe theksoi rëndësinë e parandalimit të agresionit të Serbisë ndaj Kosovës.

Ndërkaq në lidhje me zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik diskutimi u fokusua në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ekonomik në mes dy vendeve, sjelljen e investitorëve japonezë në vendin tonë si dhe përgatitjen e Republikës së Kosovës për pjesëmarrje në Expo 2025 në Osaka.

Bashkëpunimi në fushën akademike, respektivisht në mes të universiteteve të të dyja vendeve, ishte një tjetër temë e këtij takimi, për të cilën pritet edhe nënshkrimi i një memorandumit të mirëkuptimit në mes të institucioneve respektive.

Zëvendësministrja Gashi për fund falënderoi ambasadorin Mizuuchi për vizitën dhe shprehë gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë në fushat me interes të përbashkët në mes dy vendeve.

40 000 banorë të Prishtinës bëhen për herë të parë me ngrohje qendrore sivjet

PRISHTINË, 4 TETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se 40 000 banorë të Prishtinës bëhen për herë të parë me ngrohje qendrore sivjet. "Kjo falë punës së pandalshme të ndërmarjes 'Termokos' këtë verë", ka thënë ai pas vizitës punimtare në lagjen "Arbëria", ku po shtrohet 700 metrat e fundit për këtë vit. "I

falënderova fillimisht punëtorët e inxhinierët e angazhuar në shtrirjen e mbi 16 kilometrave gyp këtë verë. Siç dhe falënderova kryeshefin Fisnik Osmanin, e kryetarin e Bordit, Visar Vokrrin për një drejtim shembullor të ndërmarjes. Mbështetja jonë për ta, nëpërmjet asamblesë e aksionarëve tanë, e gjithë qeverisjes lokale do të

vazhdojë tutje. Vetëm këtë verë, Termokos ka punuar në lagjet Dardani, Ulpianë, Qendër, Qafë, Bregu i Diellit, Dodonë, Mat I e Arbëri. Punë e madhe, angazhim profesional, shërbim për qytetarë. Në 'Rugën e Re' kemi paraparë plot 120 milionë euro investime me qëllim të dyfishimit të qasjes në ngrohje", ka thënë Abdixhiku.



Për gjashtë muaj Kuvendi shpenzoi afër 4 milionë euro

Mbi 3.8 milionë euro ka shpenzuar Kuvendi i Kosovës vetëm në periudhën e parë të këtij viti. Këto të dhëna u paraqitën të mërkurën në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 4 TETOR - Në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, u.d i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës, Arben Loshi, ka paraqitur raportin e shpenzimeve për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023 për pesë kategori. Sipas Loshit, shpenzimet e Kuvendit prekin shumë prej tre milionë e 880 mijë e 950 eurosh ose 35.74 për qind e realizimit të buxhetit për vitin 2023. Gati 4 milionë euro shpenzime të Kuvendit të Kosovës, deputetët e opozitës dhe mazhorancës ankohen për mungesë të kushteve për punë.

Deputeti nga Vetëvendosja, Visar Korenica, ka shprehur kritika ndaj anëtarëve të administratës së Kuvendit. Ai ka kërkuar përgjigje lidhur me pajisjet elektronike në Kuvend për votim, i cili ka treguar se tash e disa vjet nuk janë funksionale. "Statusi i pajisjeve të Kuvendit që nuk janë funksionale tash e një kohë po krijon probleme gjatë votimit. Shpeshherë edhe zërimi nuk është në rregull. Çka nuk po funksionon me pajisjet e

zërimin, nuk është në funksion të plotë sistemi apo vetëm pjesa e votimit. Duhet dikush ta marrë përgjegjësinë pse sistemi nuk funksionon pothuajse për tri vjet. Nuk mund t'i pranoj arsyetimet. Nuk ka mundësi mos me pas një operator që e kryen një punë teknike", ka thënë Korenica.

Për këtë, Loshi ka thënë se ka probleme teknike dhe se përgjegjësia nuk është tek administrata e Kuvendit. "Sa iu përket pajisjeve, ka probleme që disa vjet. Një pjesë e mikrofonave nuk janë funksionale. Nuk ka përkrahje. Nuk prodhohen më këto pajisje. Nuk ka në treg. Prodhuesi e ka mbyllur sa i përket atij lloji. Në të dy rastet ka probleme teknike, për atë qëllim është planifikuar buxheti për blerjen e pajisjeve të reja. Ky projekt është në procedurën e realizimit. Përgjegjësia nuk është tek Administrata e Kuvendit", ka thënë Loshi.

Ndërkaq deputeti nga radhët e PDK-së, Mërgim Lushtaku, ka potencuar se shpenzimet e kryetarit të Kuvendit duken të jenë goxha të jashtëzakonshme, derisa ka kërkuar edhe shpjegime për to.



"Mbi 51 mijë euro janë shpenzuar për kryetarin dhe kabinetin e tij për shëtitje brenda dhe jashtë vendit për dreka dhe darka. Duket goxha një shpenzim i jashtëzakonshëm. A ka pasur planifikime. Është një shpenzim i jashtëzakonshëm. A ka pasur planifikime aq të mëdha për një periudhë kaq të shkurtër", ka potencuar Lushtaku. Për këtë Loshi ka bërë me dije se sa iu përket këtyre shpenzimeve vendos Kryesia e Kuvendit. "Çdo shpenzim i kryetarit, e

nënkryetarit, deputetit për udhëtim zyrar brenda dhe jashtë për akomodim bëhet me vendim të kryesisë. Çdo shpenzim administratë Kuvendi e zbaton. Ka për detyrë dhe obligim t'i zbatojë vendimet. Vendimet e Kryesisë janë të detyrueshme për zbatim nga administrata e Kuvendit", ka potencuar Loshi. Ankesa pati edhe nga deputeti i AAK-së, Pal Lekaj. Lekaj, po ashtu, ngriti sërish shqetësimin për zyrat e deputetëve. Sipas tij, takimet e

punës po bëhen në kafene për shkak të mungesës së zyrave. "Është kërkesë që të kemi zyra. Sa keni tentuar të gjeni hapësira që të akomodohen deputetët? Kërkesa është e kamotshme, por s'është realizuar, vetëm një zyrë dhe jo t'i bëjmë takimet në kafene", ka deklaruar Lekaj.

Lidhur me këtë, Loshi ka deklaruar se për momentin nuk ka ndonjë zgjidhje për këtë çështje. "Për momentin nuk është që ka një objekt ose zgjidhje të caktuara për këtë çështje", ka shtuar Loshi.

Guvernatori i BQK-së thotë se mungesa e Kartonit të Gjelbër po shkakton pengesa për bizneset e qytetarët



PRISHTINË, 4 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka takuar drejtuesit e lartë të Këshillit të Byrove në Bruksel, Sandra Schwarz - presidente dhe Greet Flore - drejtoreshë Menaxhuese. Pjesë e delegacionit ishin edhe përfaqësuesit nga Byroja Kosovare e Sigurimit dhe zyrtarë

të Ambasadës së Kosovës në Bruksel.

Guvernatori Ismaili i informoi për zhvillimet e fundit dhe përparimin në sektorin financiar, me theks në industrinë e sigurimeve në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, guvernatori Ismaili argumentoi nevojën dhe

pengesat që mungesa e Kartonit të Gjelbër shkakton për bizneset, qytetarët e vendit tonë dhe diasporën lidhur me lëvizjen e lirë.

Për të arritur këtë objektiv të rëndësishëm për lëvizje të lirë të njerëzve dhe mallrave u diskutuan mënyrat dhe aranzhmanet e mundshme për

adresimin e kësaj çështjeje. Drejtuesit e lartë të Këshillit të Byrove falënderuan delegacionin e Republikës së Kosovës për vizitën dhe u shprehën të gatshëm t'i shqyrtojnë mundësitë dhe aranzhmanet potenciale alternative për një zgjidhje të kësaj çështjeje. Megjithatë, ata rikujtuan se kufizimet ligjore që

vijnë nga Statuti i Këshillit të Byrove përbëjnë sfidën kryesore që kërkon kohë për adresim.

Guvernatori Ismaili theksoi përkushtimin e BQK-së për këtë qëllim, mbështetjen nga Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur një zgjidhje në këtë drejtim.

Krijimtaria artistike dhe inteligjenca artificiale



Nga: Donika ÇAPI

Tabloja titullohet Théâtre d'Opera Spatial. Edhe pse ka zgjedhur ta titullojë në frëngjisht, autori është amerikan. Quket Jason Allen, me profesion është ideator dhe krijues i lojërave elektronike.

Kjo vepër u shfaq në Panairin Artistik të Shtetit të Kolorados (ShBA), më 22 gusht 2022. Juria e vlerësoi me çmimin e parë në kategorinë: "Digital Art" [art digjital]. Që prej atëherë, tabloja dhe autori i saj mbeten objekt i diskutimeve.

Mund të quhet kjo tablo një vepër arti?! Si është lejuar një tablo e tillë të ekspozohet si punë artistike?! Mbi ç'bazë autori i saj na qenka artist?! Si mund të vlerësohet ky punim me një çmim?! Dhe, aq më tepër me çmim të parë! Ku kanë humbur vlerësuesit, interpretuesit, kritikët e artit? Në çfarë bote po jetojmë?

Mund ta marrim pak më qetë? Estetikisht, tabloja qëndron. Subjekti është i identifikueshëm: skenë operash; dritare rrethore nga ku shihet një peizazh malor; tri figura femërore, në qendër, kompozuar sipas rregullit trekëndor. Veshjet e grave janë po ashtu të identifikueshme: kombinim i balancuar mes periudhës antike greko-romake dhe asaj të shekullit XVIII. Harmonia e vendosjes së formave

në hapësirë, e ngjyrave dhe e materialeve është korrekte. Formalisht, kjo tablo mund të cilësohet si punim artistik. Nëse këtu ka një problem, ai domosdo nuk është estetik.

Problemi, le të flasim hapur, është programi Midjourney!

Midjourney përdor inteligjencën artificiale për të dekoduar gjuhën njerëzore (të shkruar apo të folur) dhe krijon korrespondencën vizuale për çfarëdoq teksti të shkruar. Jason Alleni e përdori për të vizualizuar një "skriptë" rreth një skene të operave në hapësirë. Edhe pse "skriptat" kërkoi muaj të tërë punë kërkimore dhe përsosje linguistike, gjeneruesi i vërtetë i Théâtre d'Opera Spatial është Midjourney. Shumë studiues dhe amatorë të arteve pamore janë të bindur se kjo vepër është mashtrim dhe autori i saj mashtrues. Jason Alleni mendon të kundërtën. Këndvështrimi personal, origjinal dhe unik i autorit të "skriptës" mjafton që punimi të klasifikohet si art, edhe pse i gjeneruar nga inteligjenca artificiale. Kjo e fundit ka të bëjë vetëm me teknikën apo me mjetet e vëna në përdorim prej krijuesit.

Tashmë, organizatorët dhe kuratorët e ekspozimeve të arteve pamore kujdesen të bëjnë të qartë qëndrimin e tyre: fotografitë apo pikturat e gjeneruara nga inteligjenca artificiale nuk janë pjesë e arteve të bukura dhe nuk

mund të ekspozohen si të tilla. Impakti i Intelgjencës Artificiale nuk shihet vetëm në artet e bukura. Në vetëm një vit kalendarik, 2022-2023, një sërë profesioneesh të tjera po vihen në pikëpyetje.

Përkthyesit simultanë apo dubluesit e materialeve audio-vizive u ndeshën me një program të ri përkthimi simultan, hedhur në përdorim gjatë kësaj jave. Inteljenca artificiale përkthen diskursin e një personi nga një gjuhë në tjetrën duke përshtatur lëvizjen e buzëve të tij me fonetikën e gjuhës së përkthyer. E gjithë kjo në kohë reale. Për shembull, Donald Trump është duke dhënë një konferencë për shtyp në anglisht, transmetuar drejtpërsëdrejti nga CNN-i. Në të njëjtën kohë, në Rai Uno ai flet po "live" dhe në italisht. Përshtatja e lëvizjes së buzëve të tij përmes Intelgjencës Artificiale me fonetikën e gjuhës italiane, bën të besueshëm perceptimin se Donald Trumpi po flet në italisht. E njëjta gjë edhe me Charle de Gaullein që duket se popullit francez i adresohet në gjermanisht.

Ka një risk real që përkthyesit simultanë dhe dubluesit e filmave apo serive (mbi të gjitha të Netflix-it) të bëhen të panevojshëm në treg. Edhe pse ata besojnë se profesionalizmi i përkthyesve të talentuar nuk mund të barazohet

me inteligjencën artificiale. Këto shqetësime janë reale, por ... sigurisht që ka një "por"! Inteljenca artificiale që po rrezikon shuarjen e disa prej profesioneve më të vlefshme, realisht është vetëm një prej dimensioneve të automatizimit. Proces ky që zhvillohet prej disa shekujsh, mbase që nga industrializimi.

Automatizimi ishte dhe mbetet kusht i domosdoshëm për rritjen e produktivitetit, menaxhimin efektiv të kohës, shmangien e rrezikut të uljes së cilësisë nga përsëritja rutinore e proceseve. Ai është parakusht për zhvillimin personal apo social ngaqë zvogëlon kohën e shpenzuar me procese repetitive dhe zmadhon kohën cilësore.

Përse ky dimension i automatizimit shkakton kaq shumë panik?

Është e dukshme se dija (mbledhja dhe përpunimi i informacioneve teorike dhe praktike rreth një subjekti të caktuar) është Google-zuar dhe Wikipedia-zuar. Algoritmizimi i dijes ushtrohet në një rrjet virtual horizontal, d.m.th. pa struktura hierarkike. Të rinjve të gjeneratës Y dhe Z, monopolizimi i dijeve teorike dhe praktike nga autoritete të konfirmuara, u duket diçka totalisht "artificiale" dhe lehtësisht e zëvendësueshme.

Në këto kushte, inteligjenca

artificiale si automatizim i dijes horizontale, kryen funksionin e saj të shmangies së kohës së shpenzuar me procesin repetitiv të kërkimit të informacionit teorik e praktik në Google. Domosdo, ajo vetëm se i shërben përfuturit të një kohe cilësore që duhet kaluar duke i shërbyer mbase një tjetër lloji dijeje.

Një lloj dijeje të bazuar ndoshta te besimi në vërtetësinë e perceptimit individual, në narrativën personale që ka forca të formalizohet si unike? Me vetëdijen e plotë se nuk i mungon informacioni? Një lloj dijeje e ngjashme me atë të skriptit unik të Jason Alleni?

Aq më tepër nuk ka vend për panik, kjo formë e dijes nuk është as krejtësisht e re dhe as krejtësisht e panjohur. Në formësimin e saj, nuk dalim nga ndonjë errësirë metafizike.

Henri Bergsoni ka dedikuar një korpus gjigant filozofik kësaj lloji dijeje. E quante "intuitë", "forcë krijuese" ose "mendim që kap lëvizjen" ose "Élan vital". Procesin për të arritur te materializimi i kësaj lloji dijeje, Bergsoni e quante "Evolucion krijues" në kundërshtim me darvinizmin dhe seleksionimin natyror në shërbim të më të fortit.

Mundet që inteligjenca artificiale, më shumë sesa një rrezik, të jetë mjet që mundëson evolucionin krijues.

‘Brezi i dëlirësisë’, mit apo realitet?



Nga: Michalis STOUKAS

Duke dëgjuar për një rrip dëlirësie, mendja jonë kthehet në shekuj me histori të kalorësve që mungonin në shtëpitë e tyre për vite me radhë – duke marrë pjesë në fushata të ndryshme si kryqëzatat – dhe duke dashur të siguroheshin që gratë e tyre të mos i tradhtonin, për çfarë ato u detyruan të mbanin një konstruktion të posaçëm metalik, i njohur si rrip dëlirësie, që nuk i lejonte të kryenin marrëdhënie seksuale me një burrë tjetër pasi ky “trip” mbyllej nën brinjë me një bravë të veçantë, çelësin e së cilës burri xheloz e merrte me vete. Ishte një praktikë çnjerëzore, shtazore dhe barbare. Rripat e dëlirësisë kishin një vrimë me një kornizë të dhëmbëzuar që mezi lejonte plotësimin e nevojave të përditshme trupore. Megjithatë, në ditët e sotme ka shumë dyshime nëse zonat e tilla vërtet kanë ekzistuar. Kontakti afatgjatë i metalit me lëkurën sigurisht që do t’u shkaktonte grave probleme serioze shëndetësore: infeksione urinare, probleme të ndryshme të lëkurës, kalbje, madje edhe vdekje ... Le t’i hedhim një vështrim historik çështjes së “mbrojtjes” së dëlirësisë së grave te popujt e ndryshëm.

Zona e parë e dëlirësisë përshkruhet nga Homeri tek vepra “Odiseja”. Hefesti, perëndia i zjarrit dhe farkëtari që ishte i çalë dhe i shëmtuar, donte të hakmerrej ndaj gruas së tij Afërditës, perëndeshës së dashurisë, e cila e tradhtoi. Kështu, ai falsifikoi një rretë të hollë hekuri që i mbylli organet gjenitale ...

Romakët në vitet e para të “qytetit të përjetshëm” kishin zakonet e mëposhtëm: organet gjenitale dhe zona përreth çdo vajze të fejuar mbështilleshin me një fashë leshi shumë të hollë, të njohur si “brezi i virgjërisë”. Gramatikani latin i shekullit të dytë p.e.s., Festusi, shprehej se “asnjë lesh, sado i shtrenjtë, nuk dukej mjaftueshëm i butë për një detaj kaq të imët”. Ky brez mbyllej në bazën e tij me një nyjë të veçantë të quajtur “Nyja e Herakleut”. Kur vajza e fejuar, e shoqëruar nga të afërmit dhe miqtë, mbërrinte në pragun e shtëpisë bashkëshortore dhe pasi përfunduan ritet e dasmës së martesës, ajo mbeti vetëm me dhëndrin që po zgjidhte nyjën e Herakliut ...

Në përgjithësi, në Romën e lashtë kishte rreptësi morale. Është tregues se burri kishte të drejtë, me ligj, që ta vriste gruan nëse fryma e saj i vinte erë vere! Zonjat romake jetonin në shtëpi në shoqërinë e sklaveve të tyre

femra, duke endur dhe punuar me shtiza. Rrobat e tyre ishin të buta dhe modeste. Të rinjtë e zënë me luftëra ose me poste publike as që menduan për miqësi. Ishte një lavdi për një grua romake të kishte marrëdhënie vetëm me një burrë në jetën e saj, të ishte ‘univera’. Divorci, edhe pse i ligjshëm, pothuajse nuk u përdor ndonjëherë. Vetëm Spurio Karvixhio u divorcua nga gruaja e tij, sepse ajo nuk mund të lindte fëmijë, duke shkaktuar zemërimin e bashkëqytetarëve të tij.

Më vonë, natyrisht, pati një çlirim të moralit në Romë. Kur Jul Cezari dyshoi se gruaja e tij Pompeia po e tradhtonte me Publi Klaudin (edhe pse ka mundësi që ishte një komplot i orkestruar nga vetë Cezari), ai menjëherë u divorcua nga ajo duke thënë frazën e famshme: “Gruaja e Cezarit nuk mjafton për të qenë e sinqertë. Në vitet në vijim, romakët jetuan në shturje. Horaci i referohet fustaneve të mëndafshta të grave me rretë kocke që nuk fshehnin absolutisht asgjë. Kishte edhe femra si Telezina e përmendur nga Marciali, që ndërrojnë bashkëshortët çdo tre ditë! Ishte një akt ligjor të cilin, megjithatë, poeti e konsideroi më të pamoralshëm se edhe tradhtia

bashkëshortore më e paturpshme.

Për hebrejtë, zonat e dëlirësisë ishin të panjohura. Ata përdorën mjete jo aq të besueshme për të kontrolluar besimin e gruas së tyre. Kushdo që dyshonte se ishin viktimë e tradhtisë bashkëshortore, thërriste të afërmit dhe një prift i cili bekoji me rite të ndryshme ujin e quajtur “ujë hidhësie” dhe që ia jepte gruas për të pirë. Nëse ajo ishte një shkelëse bashkëshortore, ata besonin se uji do ta shkaktonte vdekjen e saj me konvulsione të tmerrshme. Nëse ajo ishte e pafajshme, uji nuk do t’i bënte asnjë të keqe. Besimi që gratë hebreje kishin në fe e bëri këtë mjet zbulimi shumë efektiv. Ata që nuk kishin një ndërgjegje shumë të pastër, pothuajse kurrë nuk guxuan të pinin ujin dhe rrëfyen gjithçka. Dënimi i parashikuar për shkelësit e kurorës ishte gjuajtja me gurë.

Në Greqi, asnjë masë “parandaluese” nuk u mor kurrë për të mbrojtur besimin e grave. Kurorëshkelësit dënoheshin ashpër, por shpesh nuk dënoheshin pasi grekët nuk donin që të jepeshin dënime të tmerrshme për një shkelje që nuk shkaktonte shumë dëme; nuk besonin se rrëshqitja e gruas ndikonte në nderin e burrit, por vetë gruaja rrallëherë

konsiderohej e pandershme apo e korruptuar. I gjithë inati i burrit ishte drejtuar kundër tij ... dashnorit të gruas së tij.

Një zakon i ngjashëm me rripat e dëlirësisë dhe që gjendet kryesisht në Azinë e Vogël, ishte infibulazioni (mbyllja, fiksimi me shtrëngim) e vajzave. Në një operacion të thjeshtë, por tejet të dhimbshëm, disa tregtarë mishi të bardhë qepën “buzët” e vajzave. Kur kishte një “blerës”, “tregtari” preu tegelin që garantonte virgjërinë me një brisk në prani të tij! Tregtia e “virgjërshave të qepura” lulëzoi ende në Azinë e fundit të shekullit XIX, megjithëse tregtarët e mishit u kujdesën shumë për t’iu shmangur kontrolleve të autoriteteve konsullore evropiane në tregtinë e sklevërve.

Zakone të ngjashme ekzistonin tek amerikanët që i detyronin gratë e tyre të mbanin rripa që mbylleshin me dry. Mbi to kishte shkronja dhe numra dhe vetëm me një kombinim, të cilin burri e dinte, u hapte brava! Por, edhe në shumë popuj të Afrikës ku gratë veshin një lloj kutie të trashë që mbyllon organet e tyre gjenitale ...

Gjatë viteve të kryqëzatave pati shumë ngjarje tragjike të cilat, të kombinuara me atë që panë në Lindje, i shtynë fisnikët perëndimorë të mendojnë se si

mund të jenë të sigurt që burrat e tyre nuk do t'i tradhtojnë kur ata janë larg. Teksa kalorësit luftonin në Palestinë, poetët dhe trubadurët endeshin nëpër kulla duke u bërë propozime grave që rrallëherë refuzoheshin ... Talentet dhe epshi i tyre bënë të kërkohen edhe burrat jo tërheqës. Një gungaç i tmerrshëm Adamo d'Ana, kishte kaluar nëpër dhomat e gjumit të shumë zotërinjve të shquar. Por, përveç trubadurëve kalimtarë kishte edhe rreziqe më serioze që vinin nga klerikët që mbetën në kulla, teksa kalorësit luftonin në Tokën e Shenjtë. Dhe, sigurisht që nuk qëndruan duarkryq ... Një baron francez u kthye në atdhe pas pesë vjetëve në mungesë. Në kullën e tij e gjeti një djalë të bukur trevjeçar që kishte lindur gruaja e tij! Kryqtari donte t'i bënte të gjithë gozhda xhami. Por, famullitari e siguroi se lindja e këtij fëmije ishte një mrekulli nga qielli për të shpërblyer besimin dhe vlerën e besimtarit të krishterë (d.m.th., baronit), duke siguruar shtëpinë e tij nga çdo rrezik shkatërrimi. Kishte shumë incidente të ngjashme që i bënë


perëndimorët xhelozë e të mendojnë se si do të mund të siguronin besnikërinë e gruas së tyre gjatë mungesës së tyre. Ajo që panë në Lindje u dha ide ... Thuhet se edhe në Bizant, që nga koha e Izaurianëve (717-802) e deri në vitet e Komnenëve (1081-1185) perandoreshat mbanin një lloj brezi dëlirësie. Të parët që përdorën rripat e dëlirësisë për gratë e tyre ishin ndoshta italianët. E pasuan francezët, gjermanët, anglezët dhe spanjollët që i frikësoheshin Zotit, ku kjo praktikë çnjerëzore u mbajt për shumë vite. Referencat për rripat e dëlirësisë datojnë në shekullin XIII. Kryqtarët që ktheheshin në Francë nga Palestina, duhej të largoheshin menjëherë për në Languedok në Francën jugore, ku Simon de Montfort po drejtonte ushtrinë e tij kundër Albigenëve, heretikëve kundër të cilëve Papa Inosenti III kishte organizuar një kryqëzatë. Shumë nga gratë e tyre më pas u detyruan të mbanin rripa të dëlirësisë, pavarësisht protestave të tyre. Etnologu Ileks jep një përshkrim të hollësishëm të brezit të

dëlirësisë: "Instrumenti, pamja e të cilit tregon shumë mirë shërbimin e dyfishitë që i kërkohet për ta ekspozuar në publik, është prej hekuri të punuar, i gdhendur dhe i praruar. Pjesa e përparme e tij është një lloj gjoksi që ndjek kthesën e barkut dhe në një distancë prej dhjetë centimetrash nga lartësia e belit ngushtohet sipas nevojës për të mundur të takohet me një shtrëngim që e lidh me pjesën e pasme. Pak para kësaj kapëseje, ka një hapje të vogël të dhëmbëzuar në formë ovale. Pas koprës, në pjesën e pasme tani, është hapja e dytë e cila ka formën e një tërfili. Hekuri, më pas brazda, për t'u rrumbullakosur paksa në dy pjesët e tij dhe ngrihet si pjesa e përparme ku përshtatet në një buzë të gdhendur pjesë-pjesë që synon të mbyllë përgjithmonë dy daljet natyrore nën një armaturë çeliku." Çdo rrip i dëlirësisë bëhej me porosi. Një kovaç do ta "maste" gruan fatkeqe dhe më pas do të bënte brezin e dëlirësisë posaçërisht për të ... Një tjetër përshkrim i rripit të

dëlirësisë vjen nga të dhënat e një gjyqi të mbajtur në Nimes, në Francë në vitin 1751. Një grua e çoi burrin e saj në gjykatë për akte të ndryshme të turpshme, por kryesisht për ta detyruar të vishte një rrip dëlirësie. Avokati i saj, një Frejdier, këmbënguli kryesisht në poshtërimin e gruas nga i shoqi dhe rëndësinë fyese që kishte për vetë rripin. Dhe, ai e mbylli këshillën e tij si më poshtë: "E gjithë kjo strukturë është e ndërtuar aq shumë sa nuk ka mbetur asgjë përveç një hapjeje të vogël plot projeksione që e bëjnë atë plotësisht të paarrtshme". Natyrisht, zonat e dëlirësisë nuk ishin ... të paprekshme, pasi nuk ishte e vështirë të bëheshin çelësat kundër tyre. Përmendet në mënyrë karakteristike kalimi i një armatari nga Milano që shkoi në Paris për të gjetur ... pikat e cenushme të brezit të mbretëreshës Anë të Austrisë. Ishte shumë e lehtë për të të ndërtonte një bravë me të cilën rripi hapej sa herë të dëshironte mbretëresha. Rripat e dëlirësisë u përdorën deri në fund të shekullit XVIII dhe më pas si një mjet për të parandaluar vajzat

dhe adoleshentët nga masturbimi deri rreth vitit 1930! Megjithatë, referenca individuale për përdorimin e zonës së dëlirësisë në rajone të ndryshme të Tokës bëhen edhe sot e kësaj dite ... Problemet shëndetësore që shkaktohen kur një grua vendos rripin e dëlirësisë janë të padiskutueshme. Edhe veshjet e brendshme prej kadifeje dhe materiale të tjera që kishin brezat nuk ofronin asgjë thelbësore. Kjo "mesi" çnjerëzore përfaqësonte autoritarizmin e qartë mashkullor që ushqente koncepte të tilla si nderi, xhelozia dhe besnikëria martesore. Sot gjithçka që përmendëm konsiderohet e paimagjinueshme dhe e papranueshme. Pozita e gruas në shoqëri është përmirësuar ndjeshëm, por fatkeqësisht disa persona vazhdojnë të kryejnë vepra penale kundër grave. Le të shpresojmë që në vitet në vijim të gjitha këto ngjarje të papranueshme të zhduken ose të zvogëlohen në minimum ... /Burimi: Protothema / Në shqip nga: Gazeta "Shqiptare"/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ballkani synon rezultat pozitiv ndaj Dinamo Zagrebit

Trajneri Ilir Daja dhe mesfushori Qëndrim Zyba janë shprehur optimist para ndeshjes që kampionët e Kosovës e zhvilloj sot ndaj Dinamo Zagreb, në kuadër të fazës së grupeve në Ligën e Konferencës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 TETOR - Skuadra e Ballkanit sot (e enjte) e zhvillon ndeshjen ndaj Dinamo Zagreb në kuadër të grupeve në Ligën e Konferencës. Trajneri Ilir Daja në konferencë për medie ka thënë se janë përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje dhe se lojtarët janë të motivuar për faktin se përballë kanë një skuadër të madhe siç është Dinamo Zagreb. "Për nivelin e Dinamos nuk duhet të flitet shumë, pasi ka një eksperiencë të jashtëzakonshme dhe është përfaqësuesja më e mirë e kampionatit të Kroacisë, vend i cili ka qenë nënkampion i botës. Natyrisht se është favoriti kryesor

me Viktoria Plzen për të kaluar grupin, por ndaj një kundërshtari të tillë motivimi i lojtarëve tanë është i lartë, pra si trajner duhet vetëm të menaxhoj anën emocionale. Jemi përgatitur dhe shpresojmë që të bëjmë një gjë të bukur, por çfarë do të arrijmë do të tregojë fusha", ka thënë Daja, i cili ka thënë me pas se përparësi e skuadrës së tij në këtë edicion është përvoja në Ligën e Konferencës, pasi është hera e dytë që luan në fazën e grupeve, derisa mungesë e madh është largimi i Albion Rrahmanit dhe Meriton Korenciës si dhe lëndimi i Lindon Emerllahut. Lidhur me mungesat për ndeshjen e së enjtes, Daja ka deklaruar: "Kemi një lojtar që është në dyshim. Të shohim, por

shpresojmë ta kemi për ndeshjen sepse është i rëndësishëm për ekipin". Në konferencën me medie krahas trajnerit Daja ishte edhe Qëndrim Zyba. Ky i fundit beson se djelmohat e skuadrës nga Suhareka mund të arrijnë një rezultat pozitiv. "Është një ndeshje e rëndësishme dhe e vështirë, por ne jemi të motivuar maksimalisht. Ne do të japim gjithçka nga vetja për të marrë një rezultat pozitiv. Dinamo Zagreb ka një superskuadër që ka qenë në Ligën e Kampionëve por edhe në Ligën e Evropës e tash në Ligën e Konferencës", ka deklaruar Zyba. Ndeshja Ballkani-Dinamo Zagreb i takon Grupit C dhe zhvillohet nga ora 18:45 në stadiumin "Fadil Vokrri".

SHKURT

Ndeshja Zvicër - Kosovë zhvillohet në Basel

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll më 18 nëntor do të përballë me Kombëtaren e Zvicrës në kuadër të ndeshjes së dytë kualifikuese për "Euro 2024". Federata e Futbollit e Zvicrës sot ka njoftuar se ndeshja në mes të përfaqësueses helvetike dhe dardane do të luhet në Basel. Takimi i vlefshëm për kualifikimet e "Euro 2024" do të luhet në stadiumin "Jakob-Park" më 18 nëntor, me fillim nga ora 20:45. Ndërsa shitja e biletave fillon nga 20 tetori, e që interesim të madh do të ketë nga shqiptarët që jetojnë në Zvicër. Në ndeshjen e parë mes këtyre dy shteteve që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" rezultati final ishte 2-2.

Majlinda Kelmendi nderohet në Krujë

Kampionia olimpike Majlinda Kelmendi e ka vizituar së fundmi muzeun historik dhe etnografik në Krujë. Ky muze e ka mirëpritur sportisten nga Peja, kurse ajo është shprehur e lumtur për vizitën. "Kënaqësi të mirëprisnim në Muzeun 'Gjergj Kastrioti Skënderbeu' kampionen Majlinda Kelmendi që vazhdimisht na ka bërë krenarë me sukseset e saj në arenën ndërkombëtare", shkruhet në faqen e muzeut. Majlinda Kelmendi tash e një kohë është bërë trajnere e xhudos dhe me shumë sukses po i udhëheq sportistet e saja.

Batatina mirëpret rikthimin e Veliut: Më mungonte prania e tij në fushë

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, e ka mirëpritur rikthimin e futbollistit Valmir Veliu. 23-vjeçari u rikthye në ekipin e zezër pas përvojës që e pati në Turqi me Gaziantepin dhe Istanbulsporin. Batatina ka bërë me dije se i ka munguar Veliu, por tash së bashku do të përpiqen ta shkruajnë historinë e klubit. "Rikthimi në momentet më vendimtare për skuadrën time sepse më mungonte prania e tij në fushë dhe shkathtësitë e tij individuale. Atëherë kur Llapi dëshiron të shkruajë historinë e klubit, ai është prapë me ne së bashku për të arritur gjëra madhore. 'Legjendat' prapë e shohin të dielën në fushën e gjelbër, këmbëshpejtin e Llapit, Valmir Veliu", ka shkruar Batatina.

'Australian Open' do të zgjasë 15 ditë nga viti i ardhshëm

"Australian Open" do të bëhet një ngjarje 15 ditore për herë të parë në vitin 2024, në një përpjekje për ta reduktuar numrin e ndeshjeve që zgjatën pas mesnatës në Melbourne Park. Programi i turneut u vu në dyshim në janar pasi Andy Murray e përshkroi përfundimin e tij në 4 të mëngjesit si të papranueshme. Tani Grand Slam ka shtuar një ditë dhe do të fillojë të dielën, më 14 janar. Një minimum prej dy ndeshjesh do të caktohen për seancat ditore në gjykatat kryesore, në vend të tre, për ta zvogëluar rrezikun e vonësës së seancave të natës. Drejtori i turneut Craig Tiley ka deklaruar: "Ne kemi dëgjuar reagimet nga lojtarët dhe tifozët dhe jemi të ngazëllyer për të ofruar një zgjidhje për t'i zvogëluar përfundimet e vona, ndërsa vazhdojmë të ofrojmë një orar të drejtë dhe të barabartë në gjykatat e stadiumit". "French Open" është një turne 15-ditor, ndërsa "Wimbledon" dhe "US Open" luhen për 14 ditë.

Donjeta Sadiku shpallet kampione ballkanike

PRISHTINË, 4 TETOR - Në finale të Kampionatit Ballkanik në Albena të Bullgarisë në ring për titullin e kampionës ballkanike u paraqit Donjeta Sadiku kundër boksieres nga Ukraina Dovolga Tetiana. Donjeta bëri boks të mirë gjatë tre raundeve dhe shpesh e solli në gjendje të palakmueshme kundërshtaren. Në raundin e dytë e solli në nokdaun dhe me rezultat unanimit u shpall fituese dhe u stolis me medalje të artë dhe titull Kampione Ballkanike 2023.

Kosova në Kampionatin Ballkanik "Albena 2023" fitoi pesë medalje: 1 medalje të artë Donjeta Sadiku dhe 4 të bronzta, 54 kg Bashkim Bajoku; 67 kg Shpetim Bajoku; 71 kg Patriot Behrami; 86 kg Taulant Jakupi. Po ashtu, gjyqtari ndërkombëtar, Latif



Demolli, u shpërblye me drejtësinë në këtë mirënjohje për ndarje të Kampionat Ballkanik.

Verstappeni: Dua ta fitoj titullin të shtunën në garën sprint

AMSTERDAM, 4 TETOR - Këtë fundjavë, në pistën e Katarit, piloti holandez Max Verstappen mund ta kurorëzojë titullin e tretë kampion bote për pilotë në Formula 1. Atij i mjaftojnë vetëm tri pikë për të qenë

sërish numri një. Pikë që mund të vijë që ditën e shtunë, gjatë garës sprint, të cilën holandezi dëshiron ta fitojë me çdo kusht. Verstappen i shpreh se dëshiron t'i mbyllë hesapet që të shtunë. "Është bukur të jesh

në Katar kur e di që ke fituar titullin për konstruktorë. Do të jetë një fundjavë e vështirë, pasi bën shumë vapë dhe kjo do ta bëjë interesante garën. Këtë fundjavë ka edhe një garë sprint, ndaj lodhja do të jetë e madhe", ka thënë Verstappen.

"Për fat të mirë, kampionati për pilotë mund të mbyllet që ditën e shtunë, ndaj dua të përfitoj nga kjo mundësi. Ky është objektivi im dhe i skuadrës. Shpresoj që kjo të jetë një fundjavë që do ta mbaj mend gjatë", ka shtuar Verstappen.



Ramadani: Nuk e kam problem Serinë A, jam stërvitur nga trajnerë italianë

LECCE, 4 TETOR - Ylber Ramadani është në hapat e tij të para në futbollin italian, aty ku u transferua këtë verë nga radhët e Aberdeeni te Lecce. Mesfushorët të kombëtares i mjaftuan shtatë ndeshje në Serinë A për t'u shndërruar në lider dhe për t'i marrë në dorë çelësat e mesfushës së skuadrës puljeze. Në konferencën për shtyp para ndeshjes së radhës me Sassuolon, 27-vjeçari shqiptar theksoi se për të nuk ishte shumë e vështirë të përshtatej me futbollin italian pasi në të kaluarën është stërvitur nga trajnerë italianë. "Ndaj Napolit humbëm, edhe pse në fushë u futëm për një rezultat pozitiv. Në fillim gara ishte e ekuilibruar dhe patëm dy mundësi të mira, nëse do të kalonim në avantazh atëherë ndeshja do të kishte marrë një tjetër rrjedhë. Por, në fund rezultati ishte i drejtë dhe duhet të punojmë më shumë për t'u rikthyer te rezultati pozitiv ndaj Sassuolos. Ata janë një skuadër e fortë dhe që ka fituar me Juventusin e Interin, por ne



do të mundohemi ta marrim maksimumin. Luajmë në shtëpi para tifozëve tanë dhe kjo na motivon më tepër. Jam stërvitur mirë. Detyra ime është të garantoj ekuilibër në fushë", ka thënë Ramadani. "A jam i lodhur pas ndeshjeve me Napolin dhe Juven? Jemi profesionistë dhe duhet të rikuperohejmë shpejt. Kalendarit ka 38 ndeshje. Këtu në

Itali futbollit është më fizik se në Skoci, atje sulmohej më shumë, por për mua nuk ka problem pasi jam stërvitur me trajnerë italianë. Lojtari që më ka impresionuar më shumë është Anguissa dhe Osimhen të Napolit. E vërteta e ofertës nga Verona? Verona më kërkoi ta prisja dhe unë zgjodha Leccen prej seriozitetit që tregoi", ka shtuar Ramadani.

Bayerni thëllon rekordin në Danimarkë, Mulleri 'kap' Casillasin

MÜNCHEN, 4 TETOR - Në letër ishte një "lojë fëmijësh" për Bayern Munchenin, por në Ligën e Kampionëve, në nivele të tilla, asgjë nuk vjen lehtë. Ekipi i Thomas Tuchel vuajti jo pak në transfertë përballë Copenhagenit, siguroi një fitore me përmbysje duke zgatur më shumë rekordin e pabesueshëm. Kjo ishte ndeshja e 36 radhazi në fazën e grupeve që Bayerni nuk pëson humbje (33 fitore dhe 3 barazime). Simboli i këtij ekipi është pa diskutim Thomas Muller, me këtë sukses sulmuesi kap Iker Casillas si lojtari i dytë me më shumë fitore në Ligën e Kampionëve, plot 101. Pas një pjese të para të mbyllur me rrjeta të paprekura, Copenhageni kaloi në avantazh në minutën e 56. Bayerni reagoi shpejt dhe në



minutën e 67 Musiala me një aksion personal barazoi shifrat në 1-1. Në të 83-të, Mulleri dhuroi një asistim fantastik për Tel me sulmuesin francez që nuk fali duke i dhuruar Bayernit fitoren e dytë radhazi në Grupin A. Gjashtë pikë të plota. "E dinim që do të

ishte e vështirë, kundër një ekipi që mbrohej fort, shumë kompakt. Sfidat u bë më e vështirë pas golit të pësuar, por qëndruam të përqendruar deri në fund duke përmbysur rezultatin. Jam i kënaqur me këtë", u shpreh Tuchel pas ndeshjes.

SHKURT

Agjenti i Davisit: Kemi oferta nga Premierë Liga dhe Real Madridi

Shtohen dita-ditës zërat për transferimin e mbrojtësit kanadez Alphonso Davies nga Bayern Muncheni te Real Madridi. 22-vjeçari luan që prej vitit 2018 me "bavarezët", ku në 162 ndeshje ka realizuar 8 gola. Një lojtar që është dalluar për paraqitjet e tij, ndaj "los blancos" dëshiron ta sjellë në "Bernabeu". Lojtari ka një kontratë deri në vitin 2025 me klubin gjerman dhe kostoja e kartonit të tij shkon në 70 milionë euro. Ai që ka konfirmuar zërat është Huoseh, agjenti i lojtarit, që ka thënë: "Ka shumë skuadra që janë interesuar për të. Madje edhe nga Premierë Liga. Jam i sigurt se Real Madridi është një nga këto skuadra që është i interesuar për lojtarin. Bëhet fjalë për një lojtar të jashtëzakonshëm që e duan të gjithë".

Ancelotti: Bellinghami ka karakter të pabesueshëm

Real Madridi gjatë verës e transferoi Jude Bellinghamin nga Borussia Dortmundi. Mesfushori anglez ka pasur një fillim sensacional në Real, duke shënuar tetë gola në nëntë ndeshje, por ajo që e befason më shumë trajnerin italian Carlo Ancelotti është moshja e Bellinghamit. "Ajo që më befason te Bellinghami është fakti se ai është 20-vjeçar. Ai ka shumë cilësi, por edhe pjekuri dhe karakter të pabesueshëm për moshën e tij. Kjo është ajo që është vërtet e habitshme", ka thënë Ancelotti.

Inzaghi: Fituam me meritë

Simone Inzaghi ka thënë se Interi i tij ka fituar me meritë përballjen me Benficën (1-0) në Ligën e Kampionëve. "Pjesa e parë ishte e ekuilibruar, kishim disa raste të pastra, por duhet të ishim më të kthjellët. Në të dytën më pas rritëm intensitetin dhe djemtë u treguan të jashtëzakonshëm. Fituam me meritë këtë ndeshje, kundër një rivali me shumë vlera", ka thënë Inzaghi.

Tucheli: Nuk ishte e lehtë fitorja ndaj Copenhagenit

Trajneri i Bayern Munchenit, Thomas Tuchel, e ka pranuar se nuk ishte aspak e lehtë për ta arritur fitoren në ndeshjen ndaj Copenhagenit (1-2), në kuadër të Ligës së Kampionëve. Bayerni pësoi gol në minutën e 56, por arriti të rikthehet dhe ta përmbysë rezultatin dhe t'i rrëmbejë tri pikët e plota. "E dinim që do të ishte e vështirë, kundër një ekipi që mbrohej fort, shumë kompakt. Sfidat u bë më e vështirë pas golit të pësuar, por qëndruam të përqendruar deri në fund duke përmbysur rezultatin. Jam i kënaqur me këtë", u shpreh Tuchel.

Tifozët e Unitedit kërkojnë largimin e Onanas dhe rikthimin e De Geas

Pas humbjes në ndeshjen e parë të grupeve të Ligës së Kampionëve ndaj Bayern Munchenit (4-3), Manchester United pësoi humbje 2-3

edhe nga Galatasaray brenda në "Old Trafford", duke regjistruar kështu humbjen e gjashtë në nëntë ndeshjet e para të sezonit. Unitedi është

në krizë tashmë dhe tifozët e shohin si "faktorin" kryesor transferimin e merkatos së verës, "gardianin" kamerunas Andre Onana. Ata e kanë

humbur durimin, teksa kanë nisur një fushatë në rrjetet sociale për rikthimin e David De Geas, pasi ky i fundit u largua pak muaj më parë dhe

ka mbetur pa skuadër. Spanjollit e mbylli me Unitedin gjatë merkatos së verës pas 12 viteve me "Djajtë e Kuq".



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Mbikëqyrës i Lartë Pensioneve dhe Tregut te Letrave me Vlere
Divizioni: Mbikëqyrja Pensioneve dhe Tregut te Letrave me Vlere
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Mbikëqyrjes Pensioneve dhe Tregut të Letrave me Vlerë
Niveli i gradës: 5

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë ekipin e mbikëqyrësve në ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Kryen ekzaminimet në vend, në shqyrtimin e raporteve dhe vlerësimin e raporteve të raportuara në BQK, përcaktimin e fushëveprimit, planifikimin e resurseve dhe kohës së ekzaminimeve në vend në Fondet Pensionale,
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj Fondeve Pensionale,
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga mbikëqyrësit pensioneve për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në Fondet Pensionale,
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve, kërkesave nga ekzaminimet në vend, masave detyruese të shqiptuara ndaj Fondeve Pensionale,
- Përgatit strategjitë mbikëqyrëse komform profilin të rrezikut të fondeve pensionale, dhe rekomandon udhëheqësin e divizionit për shpeshhtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve të fokusuar në vend,
- Në rolin e mbikëqyrësit përgjegjës pas ekzaminimit në bashkëpunim me udhëheqësin e divizionit, përgatit dhe vlerëson performancën e punës së mbikëqyrësve pjesëmarrës në ekzaminim,
- Të përpiloj raport mbi gjendjen e mjeteve të investuara të tregjet financiare dhe performancën e tyre, duke përfshirë kthimin nga investimet dhe çështjet tjera,
- Ndhomon në përpilimin e politikave mbikëqyrëse, rregulloreve dhe procedurave tjera të punës,
- Detyra tjera të përcaktuara periodikisht nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes Pensioneve dhe Tregut të Letrave me Vlerë,

Edukimi:

- Të ketë të kryer fakultetin në fushën e ekonomisë, financave, kontabilitetit, matematikës, ose të ngjashme;
- Preferohet kualifikim të nivelit “Kontabilist i Certifikuar” ose “Auditor i brendshëm i Certifikuar” në institucionet përkatëse;
- Kërkojnë njohuri të mirë analitike, të nevojshme për hulumtime dhe analiza të tregjeve financiare, ku në mënyrë të pavarur vlerëson shkallen e rrezikut për sa i përket investimit të mjeteve pensionale;
- Njohuri bazike të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar;
- Të ketë njohuri të mira rreth operimit të fondeve pensionale, tregjet financiar dhe instrumenteve financiare;
- Njohuri të mira për kuadrin ligjor, rregulloret të zbatueshme ndaj fondeve pensionale për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre;
- Njohuri të vlerësimit dhe përdorimit të aplikacioneve të nevojshme kompjuterike;
- Preferohet njohuri të mira të Gjuhës Angleze;

Përvoja e punës:

- Të ketë minimum 3 vjet përvojë pune në sektorin financiar, sektorin e auditimit ose kontabilitetit.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUSTI) ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar përvojën e punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **19 tetor 2023**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.
- Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e shpalljes do të kontaktohen.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija: Viši supervizor za penzije i tržište hartija od vrednosti
Odsek: Nadgledanje penzija i tržišta hartija od vrednosti
Izveštava: Rukovodiocu Odseka za nadgledanje penzija i tržišta hartija od vrednosti
Stepen: 5

Dužnosti i odgovornosti:

- Rukovodi timom supervizora na kontrolama na licu mesta u penzionim fondovima,
- Planira, koordinira i upravlja resursima i vremenom potrebnim za kontrole na licu mesta u penzionim fondovima,
- Vršiti kontrole na licu mesta, pregleda izveštaje i procenjuje izveštaje prijavljene CBK-u, određujući obim, planiranje resursa i vreme kontrole na licu mesta u penzionim fondovima,
- Definiše delokrug kontrola na licu mesta i identifikuje obavezujuće mere nakon kontrole, prema penzionim fondovima,
- Sastavlja izveštaje o kontrolama i ocenjuje prikladnost nacrti izveštaja koje pripremaju penzioni supervizori za svoje delokrug rada, na kontrolama na licu mesta u penzionim fondovima,
- Prati sprovođenje preporuka, zahteva iz kontrola na licu mesta, obaveznih mera izrečenih penzionim fondovima,
- Priprema strategije nadzora u skladu sa profilom rizika penzionih fondova i preporučuje rukovodiocu odseka učestalost i obim kontrola fokusiranih na licu mesta,
- U ulozi supervizora odgovornog nakon kontrole u saradnji sa rukovodiocem odseka, priprema i ocenjuje radni učinak supervizora koji učestvuju u kontroli,
- Sastavlja izveštaj o stanju uloženi sredstava finansijskih tržišta i njihovom poslovanju, uključujući povrat od ulaganja i druga pitanja,
- Pomaže u izradi nadzornih politika, propisa i drugih radnih procedura,
- Ostale dužnosti koje periodično utvrđuje rukovodilac Odseka za nadgledanje penzija i tržišta hartija od vrednosti,

Obrazovanje:

- Da ima završen fakultet iz oblasti ekonomije, finansija, računovodstva, matematike ili slično;
- Poželjna je kvalifikacija nivoa „Sertifikovani računovođa“ ili „Sertifikovani interni revizor“ u relevantnim institucijama;
- Potrebno je dobro analitičko znanje, neophodno za istraživanje i analizu finansijskih tržišta, gde samostalno procenjuje stepen rizika u pogledu ulaganja penzionih fondova;
- Osnovno poznavanje međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja;
- Da dobro poznaje rad penzionih fondova, finansijskih tržišta i finansijskih instrumenata;
- Dobro poznavanje pravnog okvira, propisa koji se primenjuju na penzione fondove za procenu njihove podobnosti;
- Poznavanje procene i korišćenja potrebnih računarskih aplikacija;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno;

Radno iskustvo:

- Da ima najmanje 3 godine radnog iskustva u finansijskom sektoru, sektoru revizije ili računovodstva.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova (TRUSTI) ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje radnog iskustva;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijava je **19 oktobar 2023**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće se razmatrati.
- Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa.

